

PRIZRENI

Qytet që nuk i ka mënjanuar
barrierat për PAK



PRIZRENI

Qytet që nuk i ka mënjanuar barrierat për PAK

Autor: Fisnik Minci

Ky produkt/hulumtim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Përmbajtja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe OPDMK dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Projekti "Prizreni, një qytet pa pengesa" zhvillohet në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Përmbledhje Ekzekutive

Personat me Aftësi të Kufizuar në Kosovë në përgjithësi dhe në Prizren në veçanti përballen me diskriminimin shumëdimensional në baza ditore. Sfidat në qasjen në objekte e transport publik, shëndetësi, arsim, punësim, etj. për këtë komunitet paraqesin pengesë në drejtim të gëzimit të drejtave të garantuara kushtetuese e ligjore, gjë që bën që PAK-të të mos gëzojnë as mundësi të barabarta si pjesëtarët tjerë të shoqërisë.

Pra Kushtetuta dhe ligji, ashtu siç e potencon edhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit i vitit të kaluar mbi të drejtat e njeriut në Kosovë, ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, transportim, kujdes shëndetësor apo shërbime të tjera shtetërore. DASH ka konstatuar se qeveria nuk i ka zbatuar në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara kanë hasur në diskriminim të madh.

Një situatë e tillë e përshkruar në raportin e DASH-it haset edhe në qytetin e Prizrenit, që nuk është shumë miqësor ndaj PAK-ve. Bazuar në të dhënat e institucioneve qendrore situata nuk duket të jetë pozitive as në qytetet e mëdha të vendit, duke qenë se Prizreni është komuna e dytë për nga madhësia në Kosovë. Ndërkohë sfidat në këtë pikëpamje janë edhe më të mëdha në komunat më të vogla, ku ka prani dhe monitorim me intensitet më të ulët nga organizatat e shoqërisë civile dhe medieve.

E para, personit me aftësi të kufizuar në Prizren nuk i ofrohet mundësia që të komunikojë me kryetarin e Komunës në zyrën e këtij të fundit. Kjo mungesë e ndjesisë për ofrimin e qasjes së barabartë për PAK-të pastaj manifestohet edhe në politikat tjera publike të pushtetit lokal, e cila parimin e gjithëpërfshirjes e deklaron në dokumentet zyrtare, por nuk e zbaton në praktikë. Ky shembull bëhet edhe më bizar, kur merret parasysht fakti që në ndërtesën e KK-së së Prizrenit, ku është edhe zyra e kryetarit të Komunës, për disa vjet ka punuar edhe zëvendëskryesuesi i KK-së, i cili vjen nga komuniteti PAK.

Një hulumtim paraprak i EC-it i titulluar “Harta e Barrierave” nxjerr në pah se sikurse hapësirat publike, njëjtë edhe ndërtesat publike por edhe objektet e trashëgimisë kulturore pa përjashtim nuk përmbajnë fusha / shirita taktore për orientim të personave të verbër, pastaj pjerrinat e destinuara për qasje në hyrjen e objekteve janë jashtë standardeve, në disa raste duke arritur edhe në pjerrtësi $i=43\%$ që e bën të pamundur përdorimin e tyre nga PAK me karrocë. Ashensorët mungojnë në shumicën e ndërtesave duke pamundësuar qasjen në katet e sipërme të tyre, por edhe në rastet ku janë të instaluar, kabinat janë nën dimensionet që përcaktohen nga standardet relevante. Në 17 objektet publike të analizuara del se të gjitha kanë mangësi sa i përket përmbushjes së kriterëve të duhura për qasjen e PAK.

Mangësitë janë evidentuar edhe në institucionet publike shëndetësore dhe arsimore të Prizrenit nga Auditori i Përgjithshëm.

Edhe vet PAK-të konfirmojnë vështirësitë për jetë të pavarur në qytetin e Prizrenit, që mes tjerash është pasojë edhe e mundësive të kufizuara për të lëvizur në mënyrë të pavarur në qytet dhe për t’iu qasur vetë ndërtesave publike dhe shërbimeve të tjera në qytet. Janë të shumta barrierat me të cilat ky komunitet përballet përditë, që përpos atyre barrierave arkitektonike (fizike), përballet edhe me barrierat në komunikim, mendësinë kulturore dhe problemet shoqërore, si dhe barrierat e krijuara nga moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Strategjia Komunale e Prizrenit dhe Plani i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016-2018 është hartuar me qëllim që t’i adresojë edhe çështjet e paraqitura më sipër. Deri në muajin gusht të vitit 2016 nuk është zbatuar kjo strategji lokale. Zyrtarët komunal kanë pohuar se pushteti lokal është i përkushtuar për hartimin dhe zbatimin e politikave për avancimin e të drejtave të PAK, por se mundësitë e kufizuara financiare aktualisht pamundësojnë arritjen e rezultateve më të mëdha.

Ndërkohë edhe Gjykata Themelore në Prizren ka raportuar se nuk ka pasur asnjë lëndë sa i përket diskriminimit mbi bazat e aftësisë së kufizuar, rrjedhimisht edhe të pengimit të qasjes për PAK.

Sfidat e kësaj natyre janë të dukshme edhe në komunat më të vogla fqinje të Prizrenit, ku ka prani dhe monitorim me intensitet më të ulët nga organizatat e shoqërisë civile dhe medieve. Në këtë analizë jepen shembuj nga Malisheva dhe Suhareka.

Avokati i Popullit ka pranuar se nuk ka përmirësim të dukshëm sa i përket gjendjes së të drejtave të PAK. Sipas tij në 10 vitet e fundit veprimet e institucioneve nuk kanë arritur që të sjellin ndonjë përmirësim në aspektin e të drejtave të PAK në Kosovë.

Në anën tjetër institucionet e nivelit qendror kanë konfirmuar ecjen e ngadaltë drejtë përmbushjes së të drejtave të PAK-ve në nivel vendi. Zyrtarë të lartë qeveritarë si sfida kanë përmendur mungesën e shërbimeve shëndetësore, atyre të arsimit pastaj infrastrukturën fizike, sikurse edhe punësimin për PAK.

Ndërkohë vetëm 24 për qind të institucioneve publike shëndetësore plotësojnë kriterin e qasjes në bazë të Udhëzimit Administrativ 33/2007 të MMPH-së. Në sferën e punësimit të PAK-ve ka mjaft sfida të paadresuara nga MPMS-ja. MASHT-i ka pranuar se mungojnë kuadrot profesionale për arsimin e PAK-ve dhe se përkundër faktit që këta nxënës janë të përfshirë në sistemin arsimor, problem mbetet mungesa e cilësisë. E, MAPL-i ka bërë të ditur se vetëm 13 komuna kanë të themeluar Komitetet Konsultative për PAK, ndërkohë që 9 komuna kanë plane të veprimit për PAK. MAPL thekson se numër i madh komunash përballen me sfidën e moskompletimit të qasjes së duhur fizike për PAK-të.

MMPH-ja ka theksuar se ky dikaster qeveritar në vitet 2014 e 2015 ka shpërndarë një formular lidhur me plotësimin e kriterëve për qasjen, ku nga 38 komuna vetëm 7 prej tyre e kanë dorëzuar të mbushur formularin në këtë ministri, e cila për këtë shkak e ka të vështirë raportimin për zbatimin e UA 33/2007 të MMPH-së.

E Zyra për Qeverisje të Mirë ka nënvizuar se qasja fizike në objektet e institucioneve publike po është një problem që po i ndjekë organet shtetërore me vite të tëra, si në objektet ekzistuese ashtu edhe ato të reja. Kostoja për krijimin e qasjes fizike sipas një studimi del të jetë rreth 1 për qind të investimit të përgjithshëm në objekt. Prandaj ZQM kërkon që institucionet relevante mos të kenë tolerime sa i përket kriterit të qasjes sidomos në objektet e reja.

Në krejt këtë situatë, PAK jo vetëm që privohen nga marrja e shërbimeve apo edhe edukimi i barabartë, por dekurajohen për të konkurruar për të qenë edhe pjesë të stafit punues në institucionet e tilla publike.

I. Hyrje

Përkufizimi ndërkombëtar i termit Personat me Aftësi të Kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë. Ky është përkufizimi që jepet në nenin 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.¹

Edhe përkufizimi në legjislacionin e Kosovës është i ngjashëm për PAK.

Personat me Aftësi të Kufizuara – personat që kanë dëmtime fizike, shqisore, intelektuale ose mendore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.²

Ndërsa **Aftësia e kufizuar** përkufizohet si kufizim në qasje dhe aktivitete të zakonshme në jetën e përditshme të një personi, si pasojë e dëmtimeve

1 Neni 1, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, OKB, dhjetor 2006, linku: http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf, qasur më 11 korrik 2016.

2 Ligji Nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK, gusht 2016, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12811>, qasur më 11 nëntor 2016.

fizike, shqisore, intelektuale ose mendore, që e pengojnë atë për pjesëmarrje në aktivitet e zakonshme ditore.³

Te hapësira e ndërtuar me rëndësi është që mos të ketë pengesa dhe e njëjta ti përmbush nevojat e të gjithë njerëzve në mënyrë të barabartë. Në fakt nevojat e PAK-ve përputhen me nevojat e shumicës dhe kjo krijon lehtësira për të gjithë njerëzit. Për këtë arsye planifikimi dhe ndërtimi duhet të përmbushë nevojat e të gjitha kategorive të shoqërisë.⁴

Ndryshimet shoqërore dhe demografike në nivel global në fund të shek. XX, dhe në fillim të shek. XXI, kanë bërë që çështja e ndërtimit pa barriera të jetë qendrore në kontekstin e planifikimit të qytetit dhe të projektimit të ndërtesave dhe hapësirave publike në veçanti. Në Kosovë kjo çështje ka filluar të aktualizohet në fillim të viteve 2000, nën presionin e OJQ-ve që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara. Prania e komunitetit ndërkombëtar, e në veçanti të atij nga Bashkimi Evropian, bëri që ky presion, të ketë ndikim edhe në fushën e intervenimeve të para përmirësuese kryesisht në objekte publike. Duke qenë si problematikë e aktualizuar në këtë kontekst, në vitin 2007, si aneks i ligjit të ndërtimit nr. 2004/15, u hartua Udhëzimi Administrativ 33/2007 që përfshin Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për qasjen e personave me Aftësi të Kufizuara.⁵

Ndonëse po bëhen afër një dekadë që prej se ky Udhëzim Administrativ ka hyrë në fuqi dhe obligon institucionet e akterët tjerë që ti zbatojnë këto kërkesa teknike në projektet arkitektonike dhe urbane, një gjë e tillë nuk po ndodh në nivel të kënaqshëm, por vetëm në aspektin sipërfaqësor, gjë që dëshmohet edhe nga raportimet e autoriteteve shtetërore.

Për më shumë, planifikimi i intervenimeve ndërtuese dhe identifikimi i problemeve dhe nevojave nuk bëhet duke përfshirë komunitetin në këtë

3 Po aty.

4 "Accessibility for the Disabled - A Design Manual for a Barrier Free Environment", OKB 2003-2004, linku: <http://www.un.org/esa/socdev/enable/designm/intro.htm>, qasur më 12 gusht 2016.

5 Publikimi "Si të projektohet për një qytet pa barriera", nëntor 2016, EC Ma Ndryshe, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/161123204838_Ecmandryshe_manuali_nov2016_alb_final.pdf, qasur më 30 nëntor 2016

proces. Andaj mjedisi i ndërtuar vazhdon të jetë i paqasshëm, si dhe komunitetet e prekura nga këto aktivitete planifikuese dhe ndërtimore, në veçanti PAK, vazhdojnë të përballen me barriera në qytet. Ato pak përpjekje që bëhen për të lehtësuar qasjen, bëhen sa për sy e faqe, pa i marrë parasysh të gjitha rregullat që janë pjesë e UA 33/2007 apo nevojat e komunitetit që do ta shfrytëzojë atë mjedis. Gjithandej në qytete mund të shihen intervenime gjysmake që kanë për qëllim përmbushjen sipërfaqësore të kriterit ligjor, por jo edhe zgjidhjen e problemeve reale. Inspektorët komunalë i kapërcejnë këto kritere gjatë vëzhgimit të implementimit të këtij udhëzimi administrativ, duke u thirrë edhe në mungesë të kapaciteteve njerëzore. Kjo ndodh në të dy rastet, edhe kur kemi të bëjmë me punët përmirësuese dhe për punët e ndërtimeve të reja, të cilat normalisht do të duhej të ishin në pajtim të plotë me kriteret e këtij udhëzuesi administrativ.⁶

II. Korniza Ndërkombëtare për Personat me aftësi të kufizuara dhe Parimi i Aksesit (Qasjes)

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut përkufizon se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Gjithkush ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë sigurimin vetjak.⁷

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar që është miratuar bashkë me Protokollin Opsional në dhjetor të vitit 2006 nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara paraqet përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare për

6 Po aty

7 Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, OKB, dhjetor 1948, linku: http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf, qasur më 10 korrik 2016

përfshirjen e perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar në të gjithë aspektet e shoqërisë dhe të zhvillimit. Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre⁸.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë: Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit; Mosdiskriminimin; Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri; Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit; Mundësi të barabarta; Akses (Qasje); Barazi ndërmjet burrave dhe grave; Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.⁹

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European, në kuadër të drejtave lirive dhe parimeve të parashtruara veçon edhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar. Bashkimi European njih dhe respekton të drejtën e personave me aftësi të kufizuar që të përfitojnë nga masat që synojnë të sigurojnë pavarësinë e tyre, integrimin social dhe në punë si dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit.¹⁰ Kjo Kartë në mes tjerash ndalon edhe çdo lloj të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar.¹¹

Standardet e mira për promovimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuar janë theksuar në nismat ndërkombëtare, sikurse ajo për Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për PAK, të miratuar nga AP e OKB-

8 Po aty Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, OKB, dhjetor 2006, linku: http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf, qasur më 11 korrik 2016.

9 Neni 3, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, OKB, dhjetor 2006, linku: http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf, qasur më 11 korrik 2016.

10 Neni 26, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European, BE, linku: http://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf, qasur më 12 korrik 2016.

11 Neni 21, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit European, BE, linku: http://www.mei-ks.net/repository/docs/Traktati_i_Lisbones_-_Verzioni_i_Konsoliduar.pdf, qasur më 12 korrik 2016.

së në dhjetor të vitit 1993¹². Rregulli 5 që ka të bëj me Aksesin (Qasjen)¹³ thekson se shtetet duhet të njohin tërësinë e rëndësisë së aksesueshmërisë në procesin e barazimit të mundësive në të gjitha sferat e shoqërisë. Për personat me aftësi të kufizuar të çfarëdollojshme Shtetet duhet të prezantojnë programe për ta bërë mjedisin fizik të arritshëm; dhe të ndërmarrin masa për të siguruar aksesin tek informacioni dhe komunikimi.

a) Aksesin tek mjedisi fizik¹⁴

Shtetet duhet të ndërmarrin masa për të hequr pengesat ndaj pjesëmarrjes në mjedisin fizik. Masat duhet të jenë të tilla që të zhvillojnë standarde dhe direktiva dhe të marrin në konsideratë zbatimin e legjislacionit për të garantuar aksesin në fusha të ndryshme të shoqërisë, si strehimi, ndërtesat, shërbimet e transportit publik dhe mjete të tjera transporti, rrugët dhe mjedise të tjera.

Po ashtu duhet të garantojnë që arkitektët, inxhinierët ndërtues dhe profesioniste të tjerë që profesionalisht janë të përfshirë në projektimin dhe ndërtimin e mjedisit fizik të kenë akses në informacionin e përshtatshëm mbi politikën e aftësisë së kufizuar dhe masat për të rritur aksesin.

Kërkesat për akses duhet të përfshihen në skicimin dhe ndërtimin e mjedisit fizik që në fillim të procesit të projektimit.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuar duhen konsultuar gjatë zhvillimit të standardeve dhe normave të përshtatshmërisë. Ato duhen përfshirë gjithashtu në kushte lokale që në hapat e planifikimit gjatë përgatitjes së projekteve të ndërtimeve publike, duke garantuar kështu përshtatshmërinë maksimale.

12 Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për PAK, AP OKB, dhjetor 1993 (Rezoluta 48/96), qasur më 13 korrik 2016.

13 Po aty

14 Po aty

b) Akses i informacionit dhe komunikimit¹⁵

Personat me aftësi të kufizuara dhe, kur është e përshtatshme, familjet dhe mbështetësit e tyre duhet të kenë akses tek informacioni i plotë mbi diagnozat, të drejtat dhe shërbimet në dispozicion dhe programet, në të gjitha fazat. Një informacion i tillë duhet t'u paraqitet në formë të përshtatshme personave me aftësi të kufizuara.

Shtetet duhet të zhvillojnë strategji për të bërë të përshtatshme shërbimet informuese dhe dokumentacionin për grupe të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Braili, shërbimet me regjistrim, printimi dhe teknologji të tjera të përshtatshme duhet të përdoren për të siguruar aksesin e personave me gjymtim të shikimit tek informacioni dhe dokumentacioni i shkruar. Në mënyrë të ngjashme, teknologji të përshtatshme duhet të përdoren për të siguruar aksesin e personave me gjymtime dëgjimi ose vështirësi në të kuptuar tek informacioni i folur.

Kujdes duhet treguar në përdorimin e gjuhës së shenjave në arsimimin e fëmijëve që nuk dëgjojnë, në familjet dhe komunitetin e tyre. Shërbimi i interpretimit të gjuhës së shenjave duhet të sigurohet për të lehtësuar komunikimin mes personave që nuk dëgjojnë dhe të tjerëve.

Kujdes duhet treguar gjithashtu ndaj nevojave të personave me aftësi të tjera të kufizuara në komunikim.

Shtetet duhet të inkurajojnë medien, veçanërisht televizionin, radion dhe gazetat, për të bërë shërbimet e tyre të arritshme.

Shtetet duhet të garantojnë që informacioni i informatizuar dhe sistemet e shërbimit që i ofrohen publikut të gjerë të jenë ose të arritshme që në fillim ose të përshtaten për personat me aftësi të kufizuara.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuara duhet të konsultohen kur ndërmerren masa për të bërë shërbimet informuese të përshtatshme.

Pas kësaj nisme në fund të vitit 2006 është miratuar Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, që në vete përmban **dispozitat si në vijim për Aksesin (Qasjen)**¹⁶.

1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerët të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale.

Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera:

- (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe facilitete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës;
 - (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.
2. Gjithashtu, shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për:
 - (a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;
 - (b) Tu siguruar që subjektet private të cilat ofrojnë objekte dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuar;
 - (c) Të ofruar trajnim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë me aksesin për personat me aftësi të kufizuar;

16 Neni 9, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, OKB, dhjetor 2006, linku: http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf, qasur më 11 korrik 2016

- (d) Tu siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
- (e) Të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, duke përfshirë guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera publike;
- (f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë akses në informacion;
- (g) Të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuar ndaj informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive të reja të komunikimit, duke përfshirë dhe internetin;
- (h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

III. Korniza legjislative e Kosovës për Personat me Aftësi të Kufizuar

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantohen me Kushtetutën e Kosovës dhe ato zbatohen drejtpërdrejtë e kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike vendore. Ato janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për

Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.¹⁷

Kushtetuta e Kosovës mes tjerash thekson se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të ... "aftësisë së kufizuar".¹⁸

Ligjet më të rëndësishme të dedikuara në mënyrë specifike për PAK sipas Zyrës për Qeverisje të Mirë në Kryeministri, të listuara në Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, ZQM - ZKM¹⁹ janë:

Ligjet më të rëndësishme të dedikuara në mënyrë specifike për PAK janë:

- Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 2003/23 (është shfuqizuar nga Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, Nr.04/L-131, që ka hyrë në fuqi në maj 2016 v.j.)
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, Nr. 03/L-022
- Ligji për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 03/L-019 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078, në vitin 2016, v.j.)
- Ligji për Personat e Verbër Nr.04/L-092

17 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, linku: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>, qasur më 17 qershor 2016.

18 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, linku: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>, qasur më 17 qershor 2016.

19 Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, ZQM - ZKM, 2013, linku: https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/Docs/New%20folder/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013.pdf, qasur më 14 qershor 2014.

Ligjet që përmbajnë provizione relevante lidhur me PAK janë:

- Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125
- Ligji i Punës, Nr. 03/L-212
- Ligji mbi Ndërtimin, Nr. 2004/15 (është shfuqizuar nga Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110, që ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2012 v.j.)
- Ligji Kundër Diskriminimit, Nr. 2004/3 (është shfuqizuar nga Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015 v.j.)
- Ligji për Skemën e Asistencës Sociale, Nr. 2003/15 (i ndryshuar dhe i plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-096, qershor 2012, v.j.)
- Ligji mbi Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032
- Ligji për Sportin Nr. 04/L-075

Për më tepër përmenden edhe tre akte legislative të rëndësishme për PAK:

- Rregullorja Nr. 2000/66 mbi Beneficionet e Invalidëve të Luftës të Kosovës dhe për më të Afërmit e Tyre që Kanë Vdekur si Pasojë e Konfliktit të Armatosur në Kosovë;
- Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 07/2007
- Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Aplikimit për Njohjen e të Drejtave për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 03/2010

Sipas autoriteteve qendrore të Planifikimit Hapësinor, me Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor parashihet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara që nga faza fillestare e hartimit të dokumenteve të Planifikimit Hapësinor. Neni 4 që përkufizon parimet, në paragrafin 1.3. flet për promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor; sikurse në paragrafin 1.8 për promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor. Ndërkaq në nenin 20, Pjesëmarrja dhe Shqyrtimi Publik, autoritetet e planifikimit hapësinor para se t'i finalizojnë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor të paraparë në këtë ligj, përmes njoftimit publik ftojnë qytetarët dhe zhvillojnë konsultime dhe shqyrtime publik. Po ashtu Udhëzimi Administrativ i MMPH Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor, në nenin 5, Parimet e qeverisjes për pjesëmarrje publike, në paragrafin 4. thekson se “duke promovuar qeverisjen e mirë, Ministria dhe Komunitet marrin parasysh nevojat speciale të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, minoriteteve, të rinjve dhe çështjet gjinore.”²⁰

Por zyrtarë tjerë të organeve që veprojnë nën ombrellën e MMPH-së argumentojnë se bazuar në analizën e bazës ligjore në fuqi, duke përfshirë Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtim, mund të konstatohet se nuk ka ndonjë paragraf që në mënyrë eksplicite flet për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK). Në Ligjin për PH, përkatësisht në Udhëzimin Administrativ për Planet Zhvillimore Komunale është vetëm një paragraf, në të cilin kjo çështje trajtohet vetëm në aspektin e sigurimit të hapësirave të mjaftueshme për banim duke përfshirë edhe PAK. Ndërsa në aspektin teknik të trajtimit të çështjes në fjalë merret UA për kushtet teknike të ndërtimit i aprovuar në vitin 2007, i cili është ende në fuqi. Këto janë rregullat që duhet të përmbushen gjatë projektimit dhe ndërtimit të objekteve.²¹

20 Intervistë e hulumtueses me e-mail me Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit, Banimit, MMPH, 4 Gusht 2016.

21 Intervistë e hulumtueses me e-mail me Luan Nushi, Instituti për Planifikim Hapësinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, MMPH, 16 gusht 2016.

- a) Udhëzimi Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasje të Personave me Aftësi të Kufizuar Nr. 33/2007



Ky udhëzim është aneks i ligjit të ndërtimit dhe mëton të sigurojë qasjen e papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e PAK, si dhe modernizimin e qasjes në objektet ndërtimore publike për destinim pune, banesore-afariste, banesore, si dhe kushtet e përshtatshmërisë së thjeshtë tek objektet banesoro –afariste. Ky udhëzim përkufizon termat themelore që i përkasin aftësisë së kufizuar dhe ndërtesat publike që obligohen ta

zbatojnë këtë udhëzim, si objektet publike dhe administrative dhe ato të banimit dhe banimoro-afariste.

Për ndërtesa publike dhe administrative, ky udhëzues liston objektet që merren me veprimtari tregtare, hotelierike, bankat, postat, objektet të vetëqeverisjes lokale, objektet të qeverisjes shtetërore, administrata, gjykatat, ndërtesat e shëndetësisë dhe të rehabilitimit, ndërtesat që dedikohen për arsim, ndërtesat e kulturës, sportit, rekreimit, ndërtimet e dedikuara transportit, ndërtimet e dedikuara për argëtim, ndërtimet fetare, ndërtesat për bujtjen e dënimit, sipërfaqet dhe hapësirat publike, etj.

Udhëzimi lejon përjashtimin, pra heqjen dorë nga aplikimi i elementeve qasëse tek objektet e trashëgimisë kulturore, nëse intervenimi për të përmirësuar qasjen vlerësohet se i cenon vlerat e monumentit (neni 52), me kusht që merret pëlqimi i MMPH-së për këtë përjashtim. Sipas këtij udhëzimi, këtij vendimi duhet t'i bashkëngjitet mendimi i një organi kompetent për vlerat e objektit të trashëgimisë.

Këtij përjashtimi i nënshtrohen edhe pjesët e vendbanimit dhe objekteve ndërtimore për të cilat është përcaktuar mbrojtja në harmoni me rregulloret e veçanta nga lëmi i mbrojtjes së natyrës. Në këto raste qasja realizohet përmes elementeve të përkohshme qasëse montuese-demontuese.

Ky udhëzim jep dimensionet themelore të elementeve qasëse në nivele të ndryshme, të elementeve qasëse për jetë të pavarur (p.sh. hapësira hyrëse, komunikimi, WC, kuzhina, dhoma, klasa, hapësira e punës, banesa, kafenetë dhe restorantet, gardërobat, hyrja në ujë në pishinë, vendet në tribuna, telefonat, bankomat, instalimet elektrike, sportel, plani për orientim të lëvizjes në ndërtesa dhe të ngjashme, etj.). Po ashtu, në këtë udhëzim përfshihen edhe elementet e qasjes në komunikacion publik (vend-ndalja dhe peroni, parkingu, sipërfaqet publike për këmbësorë, semafori, vendkalimi i këmbësorëve, etj.). Të gjitha këto janë të ilustruara me skica të dimensionuara, për t'ua bërë më të qarta arkitektëve dhe inxhinierëve për zbatim në projektet e tyre.

Në fund të këtij udhëzimi jepet përmbajtja e domosdoshme e projektit arkitektonik të ndërtimit dhe të rindërtimit të objekteve arkitektonike dhe infrastrukturore, duke i përfshirë të gjitha fazat projektuese.

Ky udhëzim administrativ i përmbledh pothuajse të gjitha problemet themelore të qasjes. Mirëpo, mungon një elaborim më i thellë i problemit të qasjes në hapësira publike, shfrytëzimi i tyre dhe dizajni i mobiliarit urban për PAK, lojërat për fëmijë me aftësi të kufizuar, qasja edhe shfrytëzimi i hapësirave të gjelbra. Po ashtu, qasja për PAK në ndërtesa që bëjnë pjesë në fondin e trashëgimisë kulturore duhet të elaborohet më shumë, meqë sot ekzistojnë praktika në Evropë, por edhe mundësi teknologjike që e mundësojnë këtë. Mosinsistimi në rritjen e qasjes për PAK në këto ndërtesa dhe tërësi, mund të përjashtojë një komunitet të madh të banorëve të qytetit por edhe turistëve që të gëzojnë të drejtat për të vizituar dhe shijuar këto ndërtesa dhe mjedise. Siç u tha më lart, sot ekzistojnë zgjidhje inovative për mundësimin e qasjes me elemente që nuk cenojnë vlerat e objektit dhe që janë intervenime reversibile, ose përmes teknologjisë informative dhe të komunikimit, mundësohet qasja virtuale në to.²²

b) Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore

Qëllimi i këtij UA është përcaktimi i procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e ndërtimeve në të ardhmen me kushtet ndërtimore dhe me Kodin Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës.

22 Publikimi "Si të projektohet për një qytet pa barriera", nëntor 2016, EC Ma Ndryshe, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/161123204838_Ecmandryshe_manuali_nov2016_alb_final.pdf, qasur më 30 nëntor 2016

Formulari VIII i dedikohet Qasjes për Personat me Aftësi të Kufizuara, i cili parasheh shqyrtimin e specifikacioneve teknike, paramasën, udhëzimet teknike dhe vizatimet.

Kërkon mbushjen e formularit nëse informatat që përmbajnë specifikacionet teknike të materialeve dhe pajisjeve, paramasave me udhëzimet teknike për ekzekutimin e punëve ndërtimore, vizatimeve, vizatimeve të detajuara janë korrekte dhe të bashkërenduara?

Pastaj se a janë në përputhje sipërfaqet me ndryshime në lartësi, siç janë rampat, shkallët dhe parmakët e tyre, ashensorët dhe platformat e ngritjes?

Po ashtu se a janë korrekte dhe në përputhje dispozitat për hyrjet, lobit, hapësira e qarkullimit, WC-të, banjot, kuzhinat, dhomat, klasat e mësimi, hapësirat e punës, banesat, baret dhe restorantet, dhomat e zhveshjes, dushet, pishinat, vendi për qëndrimin e spektatorëve, telefonat publikë dhe tekstofonët, faksat, makinat ATM, telefonat publik, pajisjet elektrike të kontrollit, dorëzat e dymve dhe dritareve, sportelet e shërbimit dhe tavolinat, tabelat e njoftimit, tabelat e udhëzimeve dhe shenjat?

Dhe në fund a janë korrekte dhe në përputhje vizatimet e detajuara të elementeve të ndërtimit?²³

c) Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ndërkohë sipas Avokatit të Popullit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e ndër të tjera që kanë të bëjnë me qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për

23 Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore, MMPH, qershor 2013, linku: http://mmph-rks.org/repository/docs/ministri-ua-1921-13_409730.pdf, qasur më 5 nëntor 2016.

publikun, si dhe qasje në forma tjera të pronës (luajtshme dhe paluajtshme), dhe qasjen në vendet publike. Po ashtu sipas ligjit, me qëllim që të garantohet parimi i trajtimit të barabartë në lidhje me personat me aftësi të kufizuar, duhet të ofrohet akomodimi i arsyeshëm i personave me aftësi të kufizuar në punësim.²⁴

Çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara sipas Avokatit të Popullit përfshihen në një numër të ligjeve bazike, por aftësinë e kufizuar në mënyrë konkrete e rregullojnë: Ligji për Skemat Pensionale që Financohen nga Shteti nr. 04/L-131, Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, nr.03/L-022, Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nr.03/L-019, Ligji për ndërtim nr.04/L-110, Ligji për personat e verbër nr.04/L-092 si dhe Udhëzimi Administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje të personave me aftësi të kufizuara nr.2007/33.²⁵

d) Përmbledhje e shkurtër e ligjeve

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, Nr.04/L-131 –rregullon dhe përcakton ndër të tjera pensionet e aftësisë së kufizuar. Sipas nenit 10, Aftësia e kufizuar prej pesëdhjetë për qind që kërkohet në nënparagrafin 2.7 të paragrafit 2. të këtij neni, vlerësohet nga Komisioni Mjekësor i Ministrisë.

24 Intervistë me Hilmi Jasharin, Avokati i Popullit, ZAP, 29 shtator 2016

25 Raporti vjetor 2015, Nr.15, Institucioni i Avokatit të Popullit, linku: http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2015_IAP_FINAL_351292.pdf, qasur më 1 tetor 2016

Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, Nr. 03/L-022 - Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale.

Ligji Nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e PAK - Ka për qëllim përkrahjen ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore. Sipas dispozitave të këtij Ligji, politikat qeveritare përkitazi me aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara do të përfshijnë edhe angazhimin e institucioneve që ofrojnë aftësim profesional, për të krijuar mjedis fizik të përshtatshëm për qasje pa vështirësi për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji për ndërtim, Nr.04/L-110 – rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës. Ligji parasheh nxjerrjen e Kodit të ndërtimit me të cilin vendosen kërkesat minimale për adresimin e fuqisë strukturore, hapësirave të emergjencës, sanitarisë, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, qasjes, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve.

Ligji për Personat e Verbër, Nr. 04/L-092 – rregullon statusin ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës, përkatësisht të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbër. Neni 11 përkufizon qasjen në informacion, ku theksohet se personave të verbër u mundësohet informimi në brail, në relief, shkrim të zmadhuar, si dhe në audio për të gjithë sinjalistikën në ambientet publike informacionet publike zyrtare, literaturën tekstet, dhe librat në të gjitha nivelet shkollore në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.

Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, Nr. 05/L -067 - rregullon statusin dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor. Me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione të përfituesve të këtij ligji si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave. Te neni 12, ndër të tjera thuhet se MASHT në bashkëpunim me MMPH dhe komunat ndërmarrin të gjitha masat me qëllim që të gjitha institucionet shkollore dhe Universitetet qoftë ato private apo publike të sigurojnë kushte dhe standarde teknike të objekteve për qasje dhe qëndrim të përdoruesve të karrocave në pajtim me legjislacionin përkatës për ndërtimet.

Ligji i Punës, Nr 03/L-212 – ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate. Po ashtu ka dispozita për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara në vendin e punës.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr 05/L-021 - ka për qëllim që ta përcaktojë një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit.²⁶ Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e ndër të tjera që kanë të bëjnë me qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasje në forma tjera të pronës (luajtshme dhe paluajtshme), dhe qasjen në vendet publike.²⁷ Po ashtu sipas ligjit, me qëllim që të garantohet parimi i trajtimit të barabartë në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, duhet të ofrohet akomodimi i arsyeshëm i personave me aftësi të kufizuara në punësim.

26 Sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje Nga Diskriminimi: Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

27 Ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 – pohon se të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.

Ligji për Shëndetësi, Nr. 04/L-125 – ka për qëllim ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor. Ndër parimet e kujdesit shëndetësor është siguri i qasjes së plotë ndaj shërbimeve në Listën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pas përcaktimit të saj; për të gjithë qytetarët dhe banorët, përfshirë qasjen e lehtë deri te institucionet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Promovon standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe siguri i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës. Pos tjerash kujdesi shëndetësor zbatohet nëpërmjet masave dhe veprimeve, si trajtimi, rehabilitimi psikosocial dhe resocializimi i personave me aftësi të kufizuara në bashkësi.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare 04/L-081 – rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Personi në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin ose vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, përveç tjerash, edhe për shkak të aftësisë së kufizuar fizike apo mendore. Qendra për punë sociale ofron përkujdesje sociale ose këshillim në rrethanat, kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare, pos tjerash nëse ka aftësi të kufizuar.

Ligji për Edukimin Parashkollor, Nr. 02/L-52 - Edukimi parashkollor është e drejtë e të gjithë fëmijëve, përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta. Në pajtim me këtë ligj, fëmijët me nevoja të veçanta përfshijnë edhe fëmijët me dëmtime mentale, të verbër dhe fëmijë me dëmtime të shikimit, të shurdhër dhe ata me dëmtime të dëgjimit, fëmijët me dëmtime në të folur, fëmijët me dëmtime motorike dhe me çrregullime të sjelljes dhe emocioneve, fëmijët me dëmtime të kombinuara dhe fëmijët të tjerë në rrezik për të qenë në pozitë të pafavorshme arsimore, të cilëve u duhen instruksione të ndara me ndihmë profesionale shtesë ose programe speciale.

Ligji për Arsimin Parauniversitar, Nr. 04/L-032 - vendos rregullat ligjore në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, ashtu që të gjithë fëmijëve u sigurohet e drejta për arsim. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social. Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësisë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinionëve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.

Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës, Nr. 03/L-068 - rregullon organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunitet e Republikës së Kosovës. Sipas ligjit, MASHT është përgjegjëse të promovojë një politikë përfshirëse për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.

Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr. 03/L-149 - Një prej parimeve të rëndësishme me të cilin udhëhiqet shërbimi civil është jodiskriminimi. Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, etnike ose sociale, lidhjes me ndonjë komunitet nacional, pronës, lindjes, aftësisë së kufizuar, statusit familjar, shtatzënisë, moshës, etj.

e) Dokumentet dhe mekanizmat

Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 synon të ofrojë një kornizë të qëndrueshme të veprimeve që ka për qëllim të adresojë sfidat dhe pengesat si dhe të promovon një shoqëri gjithëpërfshirëse. Në dokument shkruan se Strategjia “do ti shërbej procesit të koordinimit dhe integritit të të gjitha politikave dhe nismave relevante në fushën e Aftësisë së Kufizuar”, sikurse që “do të jetë një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që parimet të cilat janë të mishëruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara janë inkorporuar në politikat dhe programet që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës”.

Me anë të këtij dokumenti strategjik synohet përmirësimi i gjendjes aktuale në këto fusha: Shëndetësia; Mirëqenia Sociale; Punësimi; Edukimi; Mbrojtja Ligjore; Pjesëmarrja, Informimi e Komunikimi, Qasje dhe Statistika.

Për më tepër strategjia do të shërbej si një udhërrëfyes për institucionet e Republikës së Kosovës për të punuar brenda parimeve mos-diskriminuese, duke respektuar dinjitetin e lindur, autonominë individuale duke përfshirë lirinë për t'i marrë vet vendimet dhe pavarësinë e personave, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies, pjesëmarrjen e plotë dhe efektive dhe gjithëpërfshirjen në shoqëri.

Përzgjedhja e fushave prioritare në Strategji është bërë duke marrë parasysh mangësitë ekzistuese për përmbushjen e nevojave elementare të Personave me Aftësi të Kufizuara, siç janë shërbimet shëndetësore joadekuate, mungesa e planifikimit të mirëfilltë të skemave sociale për përmirësimin e mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara, mungesa e mekanizmave implementues për zbatimin e legjislacionit për punësim dhe arsim të personave me aftësi të kufizuara, diskriminimi i heshtur ndaj personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e shoqërisë, qasja jo e mjaftueshme dhe jo e përshtatshme në jetën sociale, politike dhe ekonomike e personave me aftësi të kufizuara, mungesa e të dhënave të sakta për numrin e personave me aftësi të kufizuara, situatës jetësore dhe nevojave të tyre.

Sipas asaj që shkruan në dokument Strategjia është e strukturuar në pesë fusha të cilat përfshijnë të gjitha aspektet kryesore të jetës së Personave me Aftësi të Kufizuara me fokus në fushat si në vijim: Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Punësim, Arsimi, Mbrojtje Ligjore, Qasja (informimi, komunikimi, pjesëmarrja), Statistikat.

Objektiva Strategjike e parë është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara; Objektiva Strategjike e dytë është sistem funksional dhe i mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; Objektiva Strategjike e tretë është krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara; Objektiva Strategjike e katërt është qasje e barabarte në mbrojtje ligjore si dhe ofrimi i shërbimeve në nivelin lokal për përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe

Objektiva Strategjike e pestë është krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe në krijimin apo vendosjen e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara.²⁸

Strategjia Komunale dhe Plani i Veprimit për Persona me

Aftësi të Kufizuara 2016-2018 - Strategjia komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Prizrenit, është hartuar në përputhje dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2015, dhe gjithsesi duke i konsultuar të gjitha dokumentet tjera vendore dhe ndërkombëtare të cilat e rregullojnë çështjen personave me aftësi të kufizuar.

Qëllimi i SKPAK është gjithëpërfshirja, eliminimi i barrierave ekzistuese dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmes gëzimit të të drejtave bazë në punësim-formim profesional, arsimim, shërbime shoqërore dhe përshtatshmëri në komunën e Prizrenit.

Objektivat e strategjisë komunale për persona me aftësi të kufizuara janë: Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për PAK; Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të PAK; Ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e PAK dhe rritje të mirëqenies; Krijimi i kushteve të barabarta në qasje për PAK; E drejta në informim, komunikim, dhe pjesëmarrje në jetën publike dhe politike të PAK.

28 Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, ZQM-ZKM, linku: https://zqm.rks-gov.net/Portals/0/Docs/New%20folder/strategjia_nacionale_finale_per_shtyp_3_gjuhet_bardh_e_zi_88013.pdf, qasur më 1 shtator 2016

Kostoja e përgjithshme e strategjisë dhe planit komunal për persona me aftësi të kufizuar, për periudhë tri vjeçare, është vlerësuar në 429,500 Euro. Periudha e zbatimit përfshin vitin 2016, vitin 2017, dhe vitin 2018.

Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar – Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2015 mori vendim (nr.06/65) për themelimin e Këshillit Nacional për Persona me aftësi të Kufizuara. Ky trup udhëhiqet nga zv. Kryeministri dhe në përbërjen e vet ka zv. Ministra të ministrive relevante dhe përfaqësues të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara. Këshilli është organ këshillëdhënës dhe orientues mbi përcaktimin e prioriteteve dhe politikave nacionale në fushën e aftësisë së kufizuar.

Qëllimi i themelimit të Këshillit Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara të Kosovës është të punoj për krijimin e mundësisë së barabartë, pjesëmarrjen e plotë si dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar. Ky këshill po ashtu do të sigurojë që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar do të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime për diçka që ndikon në gjendjen dhe të drejtat e këtij komuniteti.²⁹ Në janar të vitit 2016 është themeluar Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar.³⁰ Takimi i dytë i Këshillit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është mbajtur në dhjetor të vitit 2016.

29 "Kosovë-Konsolidimi i Këshillit Kombëtar për Persona me Aftësi të Kufizuara", Platforma për mbrojtjen e fëmijëve për Evropën Juglindore, linku: <http://childhub.org/sq/lajme-mbi-mbrojtjen-e-femijeve/kosove-konsolidimi-i-keshillit-kombetar-persona-me-aftesi-te>, qasur më 25 shtator 2016.

30 "Themelohet Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar", koha.net, linku: <http://koha.net/?id=&l=94132>, qasur më 20 gusht 2016

Komitetet komunale - Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në një fushë të caktuar, Kuvendi i Komunës mund të themeloj komitete të tjera të cilat do të ndihmojnë atë dhe ekzekutivin në punën e tyre. Komitete të veçanta për PAK, sipas MAPL-it deri në 6 mujorin e parë të vitit kanë themeluar komunat e Fushë Kosovës dhe Ferizajt.

Kuvendi i Komunës është i obliguar të themeloj edhe Komitetet Konsultative më qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. MAPL-i ka raportuar se deri në 6 mujorin e parë të vitit vetëm komuna e Mitrovicës Jugore ka themeluar Komitet Konsultativ për PAK.³¹

IV. Të gjeturat nga raportet e institucioneve dhe organizatave të ndryshme kredibile

Konstatimet e institucioneve dhe organizatave të ndryshme kredibile nxjerrin në pah faktin se autoritetet ekzekutive të Kosovës nuk i kanë zbatuar në mënyrë efikase dispozitat kushtetuese e ligjore dhe si rrjedhojë Personat me Aftësi të Kufizuara janë përballë me diskriminim të theksuar në sfera të ndryshme të jetës publike.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në raportin e Auditimit të publikuar në fund të vitit të kaluar mbi qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara Fizike ka vlerësuar se qasshmëria është një nga fushat më problematike që duhet të

31 Raporti i Funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, janar qershor 2016, MAPL, linku: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/6f0edd74-8283-4b7f-b556-9bf8986f359a/Raporti-i-Funksionimit-te-Komunave-te-Republikes-s.aspx>, qasur më 29 shtator 2016.

përmirësohen, në mënyrë që të krijohet qasje më e mirë për PAK në të gjitha aktivitetet e shoqërisë (arsim, shëndetësi, punë, etj). Aktualisht këto janë pengesa të mëdha, që pengojnë PAK-ët që të gëzojnë mundësitë e barabarta të cilat qytetarët tjerë i gëzojnë. Pengesat e tilla janë barrierat strukturore në ambientet e ndërtuara, mungesa e planifikimit urban, planifikimi joadekuat i ambienteve të brendshme etj.³² ZAP ka gjetur se përkundër përpjekjeve për të përmirësuar qasjen në infrastrukturë fizike dhe hapësira për Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike, rezultatet e tanishme janë të kufizuara³³.

Ndërsa **Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2016** ka pohuar se zbatimi i Strategjisë 2013-2023 mbetet i kufizuar dhe se qeveria duhet të hartojë planin e ri të veprimit 2017-2019. Sipas këtij raporti MPMS duhet të gjej zgjidhje për të adresuar situatën e më shumë se 1 mijë personave të shurdhër që janë larguar nga skema e pensioneve në vitin 2013, derisa përkujtohet se ligji për personat paraplegjik and tetraplegjik është miratuar në maj të vitit 2016. Aty theksohet se Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar ka emëruar kryetarin e Forumit të PAK të Kosovës si bashkëkryesues, gjë që e ka bërë Këshillin më përfshirës dhe transparent. Por raporti i KE-së vë në pah se Këshilli duhet të takohet rregullisht dhe të merr rol më proaktiv për përmirësimin e mirëqenies dhe promovimit të drejtave të PAK. KE konstaton se autoritetet duhet të përmirësojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e edukimit, duke rritur numrin e personelit profesional dhe ndihmësve personal. Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2016 thekson se qasja në ndërtesat e institucioneve publike dhe transportin publik mbeten problematike.³⁴

Dhuna dhe diskriminimi shoqëror, mes tjerëve edhe ndaj personave me aftësi të kufizuar, përbënte fushën e tretë të shqetësimit të madh, në kuadër të **Raportit të Departamentit amerikan të Shtetit** të vitit 2015 mbi të drejtat e njeriut në Kosovë. Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e

32 Raporti i Auditimit "Qasja e Personave me Aftësi të Kufizuara Fizike", ZAP, nëntor 2015, linku: http://oag-rks.org/repository/docs/Qasja_per_personat_me_aftesi_te_kufizuara_fizike_256615.pdf, qasur më 13 qershor 2016.

33 Po aty.

34 Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2016, KE, nëntor 2016, linku: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf, qasur më 19 nëntor 2016.

personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore në punësim, shkollim, transportim, kujdes shëndetësor apo shërbime të tjera shtetërore. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara hasën në diskriminim të madh.³⁵

Ndërsa **Institucioni i Avokatit të Popullit** konstaton se ende ka vështirësi të shumta në gjithëpërfshirje. Problem vazhdon të mbetet qasja fizike e personave me aftësi të kufizuar në shkolla publike dhe sigurimi i transportit. Vetëm tri shkolla në Komunën e Prishtinës i plotësojnë kushtet për qasje të lirë të fëmijëve me aftësi të kufizuar për shkollim ndërsa objektet shkollore tjera përveç qasjes horizontale nuk i plotësojnë kushtet për qasje vertikale.

Institucionet përkatëse, mes tjerash, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës fizike, si dhe për ndarjen e një buxheti të veçantë për sigurimin e transportit edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Lëvizja e lirë dhe e papenguar e personave me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet problem edhe nëpër hapësira publike, institucione publike duke përfshirë edhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. Këtë shqetësim Avokati i Popullit e ka paraqitur edhe në raportet paraprake vjetore. Qasja e kufizuar për lëvizje mbetet problem më së shumti tek ata/ato pacientë/e me aftësi të kufizuara që mjet ndihmës për lëvizje e përdorin karrocën.

Ata/ato çdo herë për lëvizje duhet të jenë të shoqëruar nga ndonjë përcjellës po jo rrallë ndodhë që edhe ndihma mjekësorë tu epet në vende jo adekuate e sidomos në kujdesin parësor shëndetësor në pamundësi që ata/ato të kenë qasje në vendet ku duhet ta pranojnë trajtimin. Lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuar është e kufizuar edhe sa i përket qasjes në objektet ku ata jetojnë.

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e Personave me aftësi të kufizuara në nenin 12 parasheh punësimin në tregun e hapur të punës. Bazuar në informatat me të cilat IAP disponon, pika 2 e nenit 12 të këtij ligji

35 Raporti i vitit 2015 mbi të drejtat e njeriut në Kosovë, Departamenti Amerikan i Shtetit, linku: http://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/2016/HRreport2015_alb.pdf, qasur më 30 shtator 2016.

pothuajse në asnjë rast nuk është duke u zbatuar dhe asnjë person nuk është punësuar mbi bazën e këtij ligji. Personat me aftësi të kufizuar të cilët janë të punësuar kryesisht janë punësuar vetëm mbi bazën e meritave të tyre.³⁶

Sipas një raporti të **HandiKos**, numri i madh i personave me aftësi të kufizuar kundrejt infrastrukturës ekzistuese e cila është shumë e papërshtatshme si dhe qasjes joadekuate në objektet publike përfshirë këtu edhe qëndrimin historik negativ ndaj personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës, ka ndikuar dhe ende reflekton me apo pa dashjen tonë në përjashtimin dhe pamundësinë që personat me aftësi të kufizuar të jenë të barabartë në realizimin e të drejtave të tyre si dhe pjesëmarrjen aktive në jetën sociale, kulturore dhe politike. Është obligim jo vetëm kombëtar por edhe shoqëror që kjo problematikë dhe sfidë të luftohet me vetëdijesim të plotë për rëndësinë e një ambienti të lirë dhe pa barriera, duke punuar në përparimin sa më të shpejtë në përmirësimin e përdorshmërisë së objekteve publike, rrugëve dhe transportit publik, i cili do të jetë lehtësues për të gjithë. Nëse kjo nuk arrihet, personat me aftësi të kufizuar do të vazhdojnë të mbesin ende “të (pa)dukshëm”.³⁷

V. Sfidat aktuale dhe gjendja në Prizren / Të gjeturat e hulumtimit

Sfidat në raport me qasjen e PAK-ve janë të ngjashme në komunat e Kosovës. Më poshtë do të jepet një pasqyrim më i zgjeruar i gjendjes aktuale në Komunën e Prizrenit kundruall qasjes së PAK-ve në objektet e institucioneve publike, si administrative, shëndetësore e arsimore. Bazuar

36 Raporti vjetor 2015, Nr.15, Institucioni i Avokatit të Popullit, linku: http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2015_IAP_FINAL_351292.pdf, qasur më 1 tetor 2016.

37 Përshtatja e objekteve publike për PAK, HandiKos, 7 prill 2016, linku: http://www.handi-kos.org/repository/docs/Pershtatja_e_Objekteve_843195.pdf, qasur më 1 shtator 2016.

në këtë hulumtim situata nuk duket të jetë pozitive në qytetet e mëdha të vendit, duke qenë se Prizreni është komuna e dytë për nga madhësia në Kosovë. Ndërkohë sfidat në këtë pikëpamje janë edhe më të mëdha në komunat më të vogla, ku ka prani dhe monitorim me intensitet më të ulët nga organizatat e shoqërisë civile dhe medieve.

Qeveria lokale e Prizrenit në shtator të vitit 2015 pat miratuar kërkesën e Njesisë së të drejtave të njeriut të Komunës për punësim disa ditor të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë takim drejtori i Bujqësisë pat theksuar se ashensori në objektin e Administratës së Komunës duhet të aktivizohet, ngase në të kundërtën do të ketë probleme për qasjen e PAK-ve. Kryetari i Komunës ka pohuar se Drejtoria e Administratës duhet të angazhohet për ta eliminuar këtë problem. Ndërkaq, drejtori i atëhershëm i Urbanizmit pat bërë të ditur se ka diskutuar me drejtorin e Administratës që ashensori në objektin e Administratës komunale të riparohet, si dhe të shqyrtohen mundësitë për vendosjen e një ashensori edhe në ndërtesën e Kuvendit Komunal, përkatësisht te Shtëpia e Bardhë, që të krijohen mundësitë e barabarta për të gjithë. Ndërkohë kryetari duke e konsideruar këtë si vërejtje me vend, ka kërkuar nga vartësit e tij në Administratë të marrin masa për vënien në funksion të ashensorit.³⁸

Më shumë se një vit pas këtij diskutimi, Ekzekutivi komunal nuk ka arritur që ta riparojë ashensorin në ndërtesën e Administratës e as ta vendos një ashensor në ndërtesën e KK-së së Prizrenit, ku është edhe zyra e kryetarit të Komunës. Koordinatorja e Njesisë së të drejtave të njeriut të Komunës së Prizrenit ka theksuar se është interesuar për riparimin e ashensorit, porse përgjigja që ka marrë nga Administrata ka qenë se pajisja e nevojshme për këtë nuk mund të gjendet.³⁹

38 "Administrata, pa infrastrukturë për qasje të nevojtarëve në kate të larta", Koha.net, 26 shtator 2015, linku: <http://koha.net/?id=&l=76716>, qasur më 20 shtator 2016.

39 Mybexhele Zhuri, diskutim gjatë tryezës së organizuar në Prizren nga Organizata e Personave me Distrofi Muskulore (OPMDK) më 26 gusht 2016.


QASJA NË OBJEKT

barrierat fizike		elementet që mungojnë	
1	gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33cm	parkingu i dedikuar për PAK	11
2	qasje e vështirësuar prej trotuarit në pjerrinë	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore	12
		shenjëzimi i qasjeve të hyrjeve, shkallëve dhe pjerrinave	13
		vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve	14
		rrethoja e pjerrinës	15
		tërheqja e gardhit të shakllëve 30cm në fillim dhe fund të shkallëve	16
		dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250cm	17
		gardhi anësor i shkallëve	18

KOMUNIKIMI I BRENDSHËM

barrierat fizike		elementet që mungojnë	
3	pragu i derës më i lartë se 2cm	shenjëzimi i hapjes së derës	19
4	instalime/paisje te vendosura jashtë sipërfaqes së murit > 10cm	elementi për pastrimin e këpucëve	
5	lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15cm	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore	20
6	ashensori jofunksional	toaleti i dedikuar për PAK	
7	gjerësia e derës së ashensorit më e vogël se 90cm	sporteli i dedikuar për PAK	21
8	pllaka drejtuese e ashensorit e vendosur më lartë se 120cm	shenjëzimi i qasjes së shkallëve	22
9	përmasat e sportelit	vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve	23
	qasja në toalete përmes shkallëve		





Shembulli i mësipërm ilustron më së miri qasjen e institucioneve lokale në raport me të drejtën e PAK-ve për qasje në ndërtesa e institucioneve publike. Kështu personit me aftësi të kufizuara nuk i ofrohet mundësia që të komunikojë me kryetarin e Komunës në zyrën e këtij të fundit. Kjo mungesë e ndjesisë për ofrimin e qasjes së barabartë për PAK-të pastaj manifestohet edhe në politikat tjera publike të pushtetit lokal, e cila parimin e gjithëpërfshirjes e deklaron në dokumentet zyrtare, por nuk e zbaton në praktikë.







Ky shembull bëhet edhe më bizar, kur merret parasysh fakti që në ndërtesën e KK-së së Prizrenit, ku është edhe zyra e kryetarit të Komunës, për disa vjet ka punuar edhe zëvendëskryesuesi i KK-së, Qemajl Kurtishi, i cili vjen nga komuniteti i PAK-ve dhe i cili përditë është dashur që të përballet me sfidën e qasjes në vendin e tij të punës, ani pse ka qenë një zyrtar i lartë i zgjedhur me vota. Duke qenë përdorues i patericave ai në zyrën e tij ka qenë i detyruar që të qaset përmes shkallëve, pasi që ndërtesa që njihet si “Shtëpia e Bardhë” nuk ka ashensor për qasje në katin e sipërm. Në këtë objekt nuk ka as tualet të dedikuar për PAK, derisa pjerrina nuk është në përputhje me standardet e kërkuara.

QASJA NË OBJEKT

barrierat fizike		elementet që mungojnë	
1	pjerrtësia e pjerrinës prej 13.7%	parkingu i dedikuar për PAK	7
2	lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15cm	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore	8
3	gardhi i pjerrinës nga muri i betonit me dorezë mbajtëse e vendosur në 85cm	shenjëzimi i qasjeve të hyrjeve, shkallëve dhe pjerrinave	9
		vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve	10
		gardhi anësor i shkallëve	11
		doreza mbajtëse në mes të krahut të shkallëve më të gjerë se 250cm	12
		dorezat mbajtëse përgjatë pjerrinës e vendosur në lartësinë 60/90cm	13

KOMUNIKIMI I BRENDSHËM

barrierat fizike		elementet që mungojnë	
4	hapësira nën shkallë e pashenjësuar	shenjëzimi i hapjes së derës	14
5	pjerrtësia e pjerrinës prej 65.7% në disnivelin e korridorit	elementi për pastrimin e kepucëve	
6	hapja e derës në hyrjen kryesore bëhet në anën e brendshme	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore	15
		vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve	16
		shenjëzimi i qasjes së shkallëve	17
		fusha taktore para shkallës së parë dhe pas shkallës së fundit	18
		shenjëzimi i hapësirës nën shkallë	19
		shenjëzimi i disnivelit në korridor	20
		ashensori apo platforma e pjerrët levizëse për qasje në katin tjetër	
		toaleti i dedikuar për PAK	








Sipas Kurtishit, PAK-të përballen me diskriminimin në baza ditore, si në ofrimin e qasjes fizike ashtu edhe për shërbimet e duhura. Kurtishi ka pohuar se duhet reformim radikal në mënyrë që PAK-të të trajtohen në mënyrë më serioze nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror, sepse për këtë ato obligohen me ligj.⁴⁰

Ndërkohë hulumtimi “Harta e Barrierave” nxjerr në pah se sikurse hapësirat publike, njëjtë edhe ndërtesat pa përjashtim nuk përmbajnë fusha / shirita taktore për orientim të personave të verbër. Gjithashtu pjerrinat e destinuara për qasje në hyrjen e objekteve janë jashtë standardeve, në disa raste duke arritur edhe në pjerrtësi $i=43\%$ që e bën të pamundur përdorimin e tyre nga PAK me karrocë. Ashensorët mungojnë në shumicën e ndërtesave duke pamundësuar qasjen në katet e sipërme të tyre, por edhe në rastet ku janë të instaluar, kabinat janë nën dimensionet që përcaktohen nga standardet relevante. Për ilustrim, në kuadër të Shtëpisë së Kulturës gjendet edhe Biblioteka në katin e tretë e cila është e paarrtshme për personat me karroca për shkak të mungesës së ashensorit apo pajisjeve tjera që mundësojnë komunikimin vertikal, duke i privuar ata nga shërbimet bazike sociale, gjë që bie në kundërshtim me parimet e konceptit të gjithëpërfshirjes.⁴¹

QASJA NË OBJEKT DHE KOMUNIKIMI I BRENDSHËM

barrierat fizike		elementet që mungojnë	
1	pragu i derës më i lartë se 2cm	parkingu i dedikuar për PAK	8
2	denivelim në sipërfaqen e ecjes në koridor me lartësi 10cm	shenjëzimi i hapjes së derës	9
3	gjerësia e shkelëses së shkallëve më e vogël se 33cm	elementi për pastimin e këpucëve	10
4	lartësia e shkelëses së shkallëve më e madhe se 15cm	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore	11
5	qasja në katet tjera vetëm përmes shkallëve	toaleti i dedikuar për PAK	
6	përmasat e sportelit	sporteli i dedikuar për PAK	
7	hapja e derës së hyrjes në anën e brendshme	shenjëzimi i qasjes së shkallëve	12
		vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve	13
		ashensori apo platforma e pjerrët levizëse e dedikuar për PAK	

41 “Harta e Barrierave për qasjen dhe lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara”, EC Ma Ndryshe, nëntor 2016, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/161124111334_HARTA_E_BARRIERAVE_Raporti_final_edit_.pdf



Barrierat në hapësirat publike dhe objektet e ndryshme në Prizren janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë hulumtim. Konkretisht te ndërtesa e administratës së Komunës së Prizrenit është gjetur se gjerësia e shkelëses së shkallëve është më e vogël se 33 cm dhe se ka qasje të vështirësuar prej trotuarit në pjerrinë. Njëkohësisht mungojnë elementet si parkingu i dedikuar për PAK, fushat dhe vijat udhëheqëse taktore, shenjëzimi i qasjeve të hyrjeve, shkallëve dhe pjerrinave, rrethoja e pjerrinës, etj.

Derisa në brendi pragu i derës është më i lartë se 2 cm, pastaj ashensori është jofunksional, gjerësia e derës së ashensorit është me e vpgël se 90 cm, qasja në tualete përmes shkallëve, e mungojnë elementet si tualeti i dedikuar për PAK, sporteli i dedikuar për PAK, etj.⁴² Në objektin e Shtëpisë së Kulturës “Xhemajli Berisha” pragu i derës është më i lartë se 2 cm, qasja në katet tjera realizohet vetëm përmes shkallëve, mungon tualeti i dedikuar për PAK, e elemente të tjera.⁴³ Te Qendra Rajonale e Administratës Pensionale të Kosovës në korridor pjerrina ka sipërfaqe të rrëshqitshme, gardhi i pjerrinës është joadekuat, qasja në katet tjera dhe tualet realizohet vetëm përmes shkallëve, etj.⁴⁴ Edhe zyrat e Qendrës rajonale të Avokatit të Popullit janë të vendosur në katin e tretë të ndërtesës, ku qasja në katet tjera realizohet vetëm përmes shkallëve. Ashensor apo platforma të pjerrët lëvizëse për qasje në katet tjera nuk ka as objekti i Gjykatës Themelore të Prizrenit, ngjashëm sikurse edhe objekti i Qendrës për Punë Sociale, të cilat kanë mangësi edhe në elementet e tjera të nevojshme për PAK. Por përderisa shumica e këtyre objekteve janë ndërtuar shumë vjet më parë, Kompleksi Europa është ndërtuar pak vite më parë me mjetet e komunës dhe donatorëve europianë dhe ka mungesa të konsiderueshme sa i përket ofrimit të qasjes së duhur për PAK.

42 Po aty

43 Po aty

44 Po aty

QASJA NË OBJEKT

barrierat fizike	elementet që mungojnë
1 pragu i derës më i lartë se 2cm	parkingu i dedikuar për PAK
2 pjerrtësia e pjerrinës prej 19.4% për qasje në hyrje të objektit dhe kinema	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore 11
3 gjerësia e shkelëses së shkallës është më e vogël se 33cm	shenjëzimi i qasjeve të hyrjeve, shkallëve dhe pjerrinave 12
4 gjatësia e krahut të pjerrinës më e gjatë se 600cm pa pushimore	vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve 13
	rrethoja e pjerrinës me dorëza mbajtëse 14
	gardhi anësor i shkallëve 15
	dorëza mbajtëse e shkallëve me krah më të gjerë se 250cm 16
	fusha taktore para shkallës së parë dhe pas shkallës së fundit 17

KOMUNIKIMI I BRENDSHËM

barrierat fizike	elementet që mungojnë
qasja në katet tjera vetëm përmes shkallëve	shenjëzimi i hapjes së derës 18
5 gjerësia e shkelëses së shkallës më e vogël se 33cm	elementi për pastrimin e keputëve 19
6 lartësia e shkelëses së shkallës më e madhe se 15cm	fushat dhe vijat udhëheqëse taktore 20
7 elemente konstruktive të vendosura jashtë sipërfaqes së murit më shumë se 10cm	shenjëzimi i qasjes së shkallëve 21
8 hapësira e lirë brenda toaletit të dedikuar për PAK më e vogël se 150cm	vrazhdësimi dhe theksimi vizuel i skajit të shkelëseve të shkallëve 22
9 gjerësia e derës së toaletit të dedikuar për PAK më e vogël se 90cm	ashensori apo platforma e pjerrët levizëse për qasje në katet tjera
10 guaska joadekuate	shenjëzimi i toaletit të dedikuar për PAK 23
	mekanizmi për hapjen e derës nga jashtë në raste të thirrjes për ndihmë 24
	alarmi elektrik për shtypje dhe litar për terheqje në lartësi prej 60cm
	guaska me derrasë për ulje në lartësi 45-50cm 25
	mbajtëse fikse për duar me gjatësi 90cm dhe lartësi 80-90cm prej tokës 26
	mbajtëse dore e cila duhet të jetë palosëse për qasje në WC



Pengesa të shumta për PAK paraqiten edhe në Parkun e Qytetit. Ka vende ku shtigjet janë shumë të pjerrëta, për shkak të terrenit të pjerrtë, mungojnë parkingjet për PAK, tualetet, ulëset janë të papërshtatshme, mungojnë vijat taktore për personat e verbër, shenjëzimet për PAK, lodra dhe elemente që mund të përdoren nga të gjithë, etj.⁴⁵

HAPËSIRA TË LODRAVE PËR TË GJITHË FËMIJËT



Autoritetet lokale janë treguar pasive edhe në ndërmarrjen e masave adekuate për sigurimin e qasjes së barabartë në trotualet e rrugëve kryesore të qytetit të Prizrenit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Këto të gjetura tregojnë se institucionet shtetërore të niveleve e pushteteve të ndryshme nuk kanë treguar përkushtim të mjaftueshëm që gjatë përshtatjes së kushteve teknike për qasje në të gjitha objektet e përmendura, ti realizojnë bazuar në Udhëzimin Administrativ për kushtet teknike ndërtimore për qasjen e PAK.

Mangësitë janë evidentuar edhe në institucionet publike shëndetësore dhe arsimore. Auditori vitin e kaluar ka bërë ekzaminimin fizik të QKMF-së, katër QMF-ve dhe Shërbimit të Urgjencës në Prizren, ku ka konstatuar se QMF-të në Prizren kanë pjerrina që ofrojnë qasje për PAK, ndërkohë që dy prej QMF-ve nuk kanë pas tualete të dedikuara. Pas vërejtjeve të Auditorit është jetësuar ndërtimi i ashensorit në QKMF. Gjatë përshtatjes së

45 "Parku i Qytetit për të gjithë", EC Ma Ndryshe, tetor 2016, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/161208123218_RAPORTI_I_PUNETORISE_SE_VIZIONIMIT_PARKU_I_PRIZRENIT_RBASHA.pdf, qasur më 20 nëntor 2016.

kushteve teknike për qasje në të gjitha objektet e përmendura, Auditori ka theksuar se ato nuk janë bërë bazuar në UA për kushtet teknike ndërtimore për qasjen e PAKF. Objektet e ekzaminuara përkundër asaj që kanë qenë të pajisura me pjerrina, elementet tjera përcjellëse të rampës në këtë rast, si dorëzat mbajtëse nuk kanë qenë të vendosura që do të thotë se nuk janë plotësisht të qasshme. Po ashtu pat gjetur se mungon shënjimi në shumicën e Objekteve Shëndetësore ku tualetet janë të qasshme. Auditori pat ekzaminuar katër objekte shkollore fillore. Dy nga këto pat thënë se janë në gjendje të mirë; pra kanë rampa të qasshme poashtu dhe tualete, ndërsa njëra ka edhe ashensorë. Dy shkollat tjera fillore të ekzaminuara kanë rampa të qasshme për hyrje në shkollë, mirëpo tualetet nuk i kanë të qasshme. Shkolla e mesme e ekzaminuar nuk i plotëson kushtet për PAK, për arsye se është një objekt i vjetruar, ndërsa objekti i ri është në ndërtim e sipër pat konstatuar Auditori.⁴⁶

Përtej këtyre mangësive të sipërpërmendura ka edhe rast kur komuniteti i PAK-ve është ankuar se masat e caktuara të ndërmarra nga autoritetet lokale të Prizrenit kanë krijuar vështirësi në qasjen në hapësirat e tyre. Drejtues të shoqatës "Handikos" në Prizren kanë bërë të ditur se ka disa muaj që ndihen të ngujuar ngase nuk kanë qasje me automjet në qendrën e tyre, shkaku i gypave të betonit që janë vendosur në rrugën "Marin Barleti" si masë mbrojtëse kundruall shembjes së objekteve të vjetra. Ata kanë pohuar se i janë drejtuar me shkresë dikastereve përgjegjëse në Komunë rreth kësaj çështjeje por se ende nuk është prodhuar një zgjidhje për këtë shqetësim të ngritur.⁴⁷

46 Raporti i Auditimit "Qasja e Personave me Aftësi të Kufizuara Fizike", ZAP, nëntor 2015, linku: http://oag-rks.org/repository/docs/Qasja_per_personat_me_ aftesi_te_kufizuara_fizike_256615.pdf, qasur më 13 qershor 2016

47 Shqip Kryeziu nga "Handikos" - Prizren, diskutim në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, KK Prizren, 24 tetor 2016.



Ndërkaq sa i përket qasjes në ndërtesat publike kanë theksuar se ka sfida të konsiderueshme, meqë qasja në katet e sipërme pothuajse nuk sigurohet, me ndonjë përjashtim të vogël. Edhe pjesa e konsiderueshme e pjerrinave nuk i plotësojnë standardet, meqë ka të tilla që janë punuar me material të rrëshqitshëm, nuk kanë rrethoja e as mbuloja. Ndërsa vetëm në 2 shkolla të qytetit tualetet janë të ndara, derisa tjerat i ngjasojnë më shumë “kabinave të telefonit”.⁴⁸

Gjetjet e një hulumtimi të mëhershëm tregojnë se PAK ballafaqohen me lloje të ndryshme të barrierave, të cilat i pengojnë ata në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të njëjtë me të tjerët, duke i penguar kështu për të bërë një jetë të pavarur, të dinjitetshme dhe të vetëkënaqshme. Ndër problemet më urgjente që janë artikuluar nga PAK në Prizren janë kufizimet e lëvizjes së lirë nëpër trotuare, mungesa e pjerrinave nëpër rrugë dhe qasja në ndërtesa publike, mungesa e tualeteve publike të përshtatura për nevoja specifike, dhe mungesa e qasjes në hapësirat publike të qytetit.⁴⁹

48 Shqip Kryeziu nga “Handikos”-Prizren, Tryeza e OSBE-së në Prizren “Të drejtat e PAK në Komunën e Prizrenit”, 2 nëntor 2016.

49 Raport “Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren - Qyteti Gjithpërfshirës 2014”, dhjetor 2014, EC Ma Ndryshe, http://ecmandryshe.org/repository/docs/150126113634_Qyteti_Gjithpërfshirës_2014.pdf, qasur më 19 qershor 2016.

Në maj të këtij viti në ndërtesën e Beledijes në Prizren është realizuar një fokus grup me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim që nevojat dhe problemet me të cilat ky komunitet përballet përditë të identifikohen dhe shqyrtohen në analizë. Në këtë takim, të pranishëm kanë qenë përfaqësues me aftësi të kufizuara motorike, shqisore dhe përfaqësues të organizatave që përfaqësojnë këtë komunitet.

Gjatë diskutimit dolën në pah para së gjithash, vështirësitë e këtij komuniteti për jetë të pavarur në qytetin e Prizrenit, që mes tjerash ishte pasojë edhe e mundësive të kufizuara për të lëvizur në mënyrë të pavarur në qytet dhe për t'iu qasur vetë ndërtesave publike dhe shërbimeve të tjera në qytet. Janë të shumta barrierat me të cilat ky komunitet përballet përditë, që përpos atyre barrierave arkitektonike (fizike), përballet edhe me barrierat në komunikim, mendësinë kulturore dhe problemet shoqërore, si dhe barrierat e krijuara nga moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Disa nga problemet kritike për lëvizjen e komunitetit PAK në qytet, të cilat u diskutuan në fokus grup kanë qenë:

- Mungesa e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në transport urban,
- Mungesa e rampave për qasje në institucione publike,
- Mungesa e shenjëzimeve - sipërfaqeve taktore në trotuare, për persona të verbër,
- Uzurpimi i trotuareve nga shitësit reklamati dhe makinat e parkuara.
- Mungesa e parkingjeve të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara.
- Sipërfaqet e trotuareve dhe rrugëve nuk janë të përshtatura për shfrytëzim për persona që shfrytëzojnë karrocën: te vendkalimet e rrugëve, trotualet nuk kanë rampë dhe nëse diku gjendet rampa, ajo nuk e ka të përshtatshme pjerrtësinë;
- Mungesa e shenjëzimit me ngjyra me kontraste të forta në dysheme/trotuare, shkallë dhe shtyllëza për persona me aftësi të kufizuara pamore.

- Mungesa e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të trotuareve - mungojnë kubëzat, ekzistojnë gropat, etj., që pengojnë lëvizjen e personave me karrocë, etj.
- Ndërtimet e reja, publike apo edhe ato private që janë në shërbim të një publiku më të gjerë, nuk janë ndërtuar sipas standardeve që përshkruhen në udhëzimin administrativ nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.
- Gjerësitë e shkallëve, thellësia e basamakut, si dhe lloji i gardheve të shkallëve nuk janë sipas parametrave të përcaktuar me UA 33/2007.
- Mungojnë tualetet publike të qasshme për komunitetin PAK, në hapësira publike, në institucione komunale, kulturore, sportive, lokale shërbyese. Aty ku ekzistojnë, nuk janë të pajisura si duhet, ose kanë përmasa më të vogla dhe të papërshtatshme për shfrytëzim nga përdorues karrocash.
- Çështje që lidhet me mirëqenien sociale është edhe strehimi i këtyre familjeve. Janë të shumta familjet me një apo dy pjesëtarë me aftësi të kufizuara të cilët kanë parashtruar kërkesa për strehim në objekte shumëbanesore kolektive, etj.
- Qasja në objekte shëndetësore është mjaft e vështirësuar, meqë ka barriera fizike për përdorues karrocash.⁵⁰

Sfidat në këtë drejtim janë adresuar edhe në biseda individuale me komunitetin e Personave me Aftësi të Kufizuar në Prizren. Për Sulltane Q. aspekti i qasjes në Prizren kohëve të fundit ka shënuar përparim në krahasim me të kaluarën. Sërish sipas saj qasja në institucione është problem në Prizren, meqë ka barriera të ndryshme dhe kryesisht duhet të pritë që dikush të ofrojë ndihmë. Ajo ka theksuar se qytetarët tashmë kanë një nivel të pjekurisë dhe ofrohen për ndihmë. Megjithëkëtë Sulltane Q. thotë se kur del

50 Publikimi "Si të projektohet për një qytet pa barriera", nëntor 2016, EC Ma Ndryshe, linku: http://ecmandryshe.org/repository/docs/161123204838_Ecmandryshe_manuali_nov2016_alb_final.pdf, qasur më 30 nëntor 2016.

vetëm shkon në ato pjesë që e din se është e qasshme. Por pohon se qasja është problem edhe prej vendit ku jeton meqë aty nuk ka lift dhe që prej aty fillon problemi.⁵¹

Ndërkaq Resmije Rr. ka tërhequr vëmendjen për një aspekt që ka të bëjë me qasjen në shërbimet shëndetësore të grave që përdorin karrocë. Sipas kjo kategori e grave kur shkojnë tek gjinekologu/ja apo dentisti/ja përballen me mungesë të tavolinave hidraulike. Për mendimin e saj mos ekzistimi i këtyre tavolinave hidraulike si tek dentistët ashtu edhe tek gjinekologët është diskriminim, pasi që ua bënë të pamundshme qasjen në shërbimet shëndetësore.⁵²

Ndërsa ka prindër që kanë adresuar shqetësimet edhe për vështirësitë në qasjen e fëmijëve të aftësi të kufizuara në arsim. Linda, nëna e një fëmije me aftësi të kufizuara ka bërë të ditur se biri i saj nuk shkon në shkollë e as që merr ndonjë shërbim që prej se i ka mbushur 16 vjet, prandaj dhe ka kërkuar përkrahje për kyçjen e tij në ndonjë aktivitet edukues. Edhe prindër tjerë janë ankuar për vështirësi, veçmas qasjen në shkollë.⁵³ Drita Ç. ka pohuar se në mungesë të asistentit personal që duhet të ofrohet nga institucioni arsimor është detyruar që fëmijën e saj ta dërgoj nga shkolla e rregullt në Qendër Burimore.⁵⁴

Strategjia Komunale dhe Plani i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016-2018 është hartuar me qëllim që t'i adresojë edhe çështjet e paraqitura më sipër. Deri në muajin gusht të vitit 2016 nuk është zbatuar kjo strategji lokale, shkaku që koordinatorja e procesit ka ndërruar jetë.⁵⁵ Zyrtarët komunal kanë pohuar se pushteti lokal është i përkushtuar për hartimin dhe zbatimin e politikave për avancimin e të drejtave të PAK, por se mundësitë e kufizuara financiare aktualisht pamundësojnë arritjen e rezultateve më

51 Sultane Q., Person me aftësi të kufizuar, intervistë me hulumtuesen, gusht 2016.

52 Resmije Rr., Person me aftësi të kufizuar, intervistë me hulumtuesen, gusht 2016.

53 Diskutim në tryezën e organizuar nga OPMDK, Beledije, 24 gusht 2016

54 Drita Ç., Prind i fëmijës me aftësi të kufizuar, intervistë me autorin, nëntor 2016.

55 Mybexhele Zhuri, udhëheqëse e Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra për Çështje Gjimore, intervistë me hulumtuesen, gusht 2016

të mëdha.⁵⁶ Tutje janë dhënë vlerësime se ka pas përparime sa i përket përmirësimit të qasjes së PAK-ve në hapësirat e ndërtesat publike, por se mundësitë dhe kapacitetet e nivelit lokal nuk janë të mëdha për zgjidhjen e problemeve. Baza kryesore e çdo aktiviteti për integrimin e PAK-ve sipas drejtuesve të Komunës së Prizrenit lidhet me financat dhe se për zgjidhjen e problemeve në këtë aspekt nevojitet mbështetja më e madhe nga niveli qendror, konkretisht me mjete financiare.⁵⁷ Drejtoresha për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Prizrenit ka konfirmuar se ka njohuri për problemet në këtë fushë pasi që ka qenë e angazhuar më parë në Qendrën “Handikos” dhe sipas saj ekzekutivi lokal “do të mundohet që të gjej zgjidhje konkrete për kërkesat e PAK-ve.”⁵⁸

Ndërsa drejtori i Inspektorateve në Komunën e Prizrenit, Bujar Hasani ka shprehur bindjen se objektet e reja të institucioneve publike në Komunën e Prizrenit në përgjithësi kanë qasje për PAK-të, por ka pranuar se inspektorati lokal nuk ka kapacitet për të përcjellë zbatimin e kriterëve për qasjen e PAK-ve.⁵⁹

Ndërkohë edhe Gjykata Themelore në Prizren ka raportuar se nuk ka pasur asnjë lëndë sa i përket diskriminimit mbi bazat e aftësisë së kufizuar, rrjedhimisht edhe të pengimit të qasjes për PAK.⁶⁰

56 Mybexhele Zhuri, udhëheqëse e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Zyra për Çështje Gjinore, Tryeza e OSBE-së në Prizren “Të drejtat e PAK në Komunën e Prizrenit”, 2 nëntor 2016.

57 Lulzim Kabashi, nënkryetar i Komunës së Prizrenit, Tryeza e OSBE-së në Prizren “Të drejtat e PAK në Komunën e Prizrenit”, 2 nëntor 2016.

58 Sherife Balaj, Drejtoreshë për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Prizrenit, Diskutim në tryezën e organizuar nga OPMDK, Beledije, 24 gusht 2016.

59 “Statusi i personave me aftësi të kufizuara, i kushtëzuar nga buxheti”, Koha Ditore, 3 nëntor 2016.

60 Afërdita Kicaj, zyrtare për informim në Gjykatën Themelore të Prizrenit, komunikim me e-mail 5 dhjetor 2016.

a) Situata në komunat fqinje të Prizrenit

Siç u tha sfidat e kësaj natyre janë të dukshme edhe në komunat më të vogla, ku ka prani dhe monitorim me intensitet më të ulët nga organizatat e shoqërisë civile dhe medieve.

Një rast i diskriminimit ndaj PAK-ve ka ardhur nga kreu i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në verën e vitit të kaluar. Ai konsideronte se Fetah Rudi, një aktivist i shquar i LDK-së nuk mund të ushtronte detyrën e nënkryetarit të komunës për shkak se lëviz në saje të karrocës. “Për shkak të problemeve shëndetësore Fetahu nuk mund ta ushtroj funksionin e nënkryetarit,” pat thënë Begaj për portalin “Online.” Kur i është përkujtuar se ka pasur raste në botë që poste të larta politike e institucionale kanë mbajtur persona më aftësi të kufizuara, Begaj ka thënë se: “Atje është Gjermani, kushte të tjera janë atje, Personat me Aftësi të Kufizuara i kanë kushtet për qasje në çdo objekt e zyre.”⁶¹ Rudi qe plagosur në dhjetor të vitit 2000 në një atentat që pretendohet se ka qenë politik dhe që nga atëherë lëviz me karrocë, dhe njëkohësisht nuk e ka ndalë aktivitetin politik. Rudi pat deklaruar se nuk ka pengesa që mund ta ndalojnë atë të ushtrojë funksionin e nënkryetarit. “Pse jam në karrocë, të gjitha punët mundem me i krye dhe nuk më pengon kjo, unë jam që 15 vjet në karrocë,” pat theksuar ai.⁶² Pas kësaj Rudi i ishte drejtuar me ankesë Avokatit të Popullit lidhur me deklaratën publike të kryetarit Begaj duke e konsideruar atë diskriminuese. Ndërsa Avokati i Popullit ka propozuar ndërmjetësimin si mekanizëm juridik për çështjen e ngritur, për të cilën janë pajtuar të dyja palët dhe pas takimit me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit është arritur marrëveshja. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në të cilat ka ndodhur deklarimi dhe respektin e ndërsjellë që të dyja palët kanë shfaqur për njëra tjetrën në takimet e ndara me ta, është realizuar një takim i përbashkët, me ç’rast kryetari i Komunës ka shprehur keqardhje për situatën e krijuar pas

61 “Kryetari i Malishevës e refuzon Fetah Rudin për postin e nënkryetarit, mendon se ai nuk mund ta kryej detyrën nga karroca...”, 4 korrik 2015, linku <http://www.portalionline.com/kryetari-i-malisheves-e-refuzon-fetah-rudin-per-postin-e-nenkryetarit-mendon-se-ai-nuk-mund-ta-kryej-detyren-nga-karroca...>, qasur më 3 nëntor 2016.

62 Po aty

deklaratës së tij, të dhënë pa qëllim diskriminimi, për të cilën gjithashtu ka bërë edhe sqarim publik. Ai ka kërkuar falje për shqetësimin e krijuar me këtë rast, gjë që është vlerësuar dhe është mirëpritur nga ankuesi si formë e satisfaksionit moral dhe është përmbyllur me një akt pajtim formal juridik.⁶³

Komuna e Suharekës në postin e nënkryetarit ka emëruar një person që për shumë vjet ka punuar afër me komunitetin e PAK. Nënkryetari Rexhep Kuçi, që për një kohë të gjatë ka qenë drejtor i Qendrës Rehabilituese “Handikos” ka pohuar se ka disa përmirësime sa i përket barrierave për lëvizjen e lirë të PAK si në ndërtesat publike ashtu edhe ato private, por që duhen ende përmirësime në këtë drejtim. Sipas tij, Kuvendi i Komunës së Suharekës e ka ngritë si shqetësim lëvizjen e lirë të PAK dhe pas kësaj Drejtoria e Urbanizmit dhe ajo e Shërbimeve Publike në Komunën e Suharekës kanë iniciuar procedurën e hartimit të një dokumenti që të ndërhyhet në ato raste, si në trotuare e shkallë të ndryshme, me qëllim të krijimit të kushteve optimale për qasje të barabartë.⁶⁴

Ndërkohë përfaqësues nga Qendrat për Punë Sociale nga komunat e rajonit të Prizrenit kanë pohuar se PAK-të janë më të diskriminuarit dhe se ndonëse është bërë decentralizimi i shërbimeve sociale e se ka pas nisma të duhura, megjithatë mungojnë mjetet financiare për progres në këtë aspekt.⁶⁵

b) Konfirmimi për gjendjen jo të favorshme të PAK-ve nga institucionet e nivelit qendror

Institucionet e nivelit qendror kanë konfirmuar ecjen e ngadaltë drejtë përmbushjes së të drejtave të PAK-ve në nivel vendi. Teksa kanë konfirmuar përkushtimin për hartimin dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme ligjore,

63 Raporti Vjetor 2015 i Institucionit të Avokatit të Popullit, maj 2016, linku: http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2015_IAP_FINAL_351292.pdf, qasur më 2 shtator 2016.

64 Rexhep Kuçi, nënkryetar i Komunës së Suharekës, intervistë me e-mail me hulumtuesen, shtator 2016.

65 “Institucionet në Prizren pa qasje proaktive ndaj personave me distrofi muskulore”, Koha Ditore, 29 gusht 2016.

programeve të qëndrueshme dhe mekanizmave institucional për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave, në anën tjetër kanë pranuar se ka sfida të konsiderueshme në aspektin e ofrimit të shërbimeve adekuate shëndetësore, të arsimit, qasjes fizike dhe zgjidhjen e çështjes së punësimit.

Zëvendës kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Ramiz Kelmendi, si sfida ka përmendur mungesën e shërbimeve shëndetësore, atyre të arsimit pastaj infrastrukturën fizike, sikurse edhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar.⁶⁶

Edhe zyrtarë të ministrive të ndryshme kanë pranuar se ka sfida të numërta sa i përket respektimit të drejtave të PAK-ve. Musë Shigjeqi nga Ministria e Shëndetësisë ka theksuar se vetëm 24 për qind të institucioneve publike shëndetësore plotësojnë kriterin e qasjes në bazë të Udhëzimit Administrativ 33/2007 të MMPH-së. Qazim Gashi nga MPMS ka pranuar se në sferën e punësimit të PAK-ve ka mjaft sfida të paadresuara, derisa sipas tij aspektet tjera me të cilat merret ky dikaster janë të adresuara. Luljeta Kabashi nga MASHT ka pranuar se mungojnë kuadrot profesionale për arsimin e PAK-ve dhe ka shtuar se këta nxënës janë të përfshirë në sistemin arsimor, porse problem mbetet mungesa e cilësisë. E Luljeta Ibishi nga MAPLi ka bërë të ditur se vetëm 13 komuna kanë të themeluar Komitetet Konsultative për PAK, ndërkohë që 9 komuna kanë plane të veprimtimit për PAK. Sipas saj qasja në objektet e organeve komunale është e papërfunduar, pasi pothuajse të gjitha komunat përballen me sfidën e moskompletimit të qasjes së duhur fizike për PAK-të, dhe vetëm 15 sosh e kanë plotësuar këtë aspekt. Ndërkaq Naime Pakshtica nga MMPH-ja ka theksuar se ky dikaster qeveritar ka shpërndarë një formular lidhur me plotësimin e kriterëve për qasjen, ku nga 38 komuna vetëm 7 prej tyre e kanë dorëzuar të mbushur formularin në këtë ministri, e cila për këtë shkak e ka të vështirë raportimin për zbatimin e UA 33/2007 të MMPH-së. Sipas saj pos UA 33/2007 të MMPH-së, komunat duhet ta kenë parasysh edhe dispozitat e UA 10/2013, dhe se në bazë të një raporti të Auditorit del se Komuna e Prizrenit nuk i ka plotësuar kriteret

66 Ramiz Kelmendi, zv. Kryeministër i Qeverisë së Kosovës, diskutim gjatë takimin e dytë të Këshillit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 5 dhjetor 2016, linku: <http://kryeministri-ks.net/?page=1,9,6385>, qasur më 5 dhjetor 2016.

për qasjen në disa objekte të institucioneve publike. Armenda Berani-Shala nga ZQM ka pranuar se qasja fizike në objektet e institucioneve publike po është një problem që po i ndjekë organet shtetërore me vite të tëra, si në objektet ekzistuese ashtu edhe ato të reja. Kostoja për krijimin e qasjes fizike sipas një studimi del të jetë rreth 1 për qind të investimit të përgjithshëm në objekt. Prandaj sipas saj duhet bërë presion që mos të ketë tolerime sa i përket kriterit të qasjes sidomos në objektet e reja.⁶⁷

Në anën tjetër Avokati i Popullit ka pranuar se nuk ka përmirësim të dukshëm sa i përket gjendjes së të drejtave të PAK. Sipas tij në 10 vitet e fundit veprimet e institucioneve nuk kanë arritur që të sjellin ndonjë përmirësim në aspektin e të drejtave të PAK.⁶⁸

VI. Evropa pa barriera si model pozitiv

Çmimi për Qytetin me Qasjen më të Mirë është një nga aksionet i parashikuar në strategjinë e BE-së për personat me aftësi të kufizuar e cila mëton që ta bëjë Evropën një kontinent pa barriera për personat me aftësi të kufizuar. Çmimi mëton t'i inkurajojë qytetet me së paku 50,000 banorë që të ndajnë përvojat e tyre dhe të përmirësojnë qasjen për të mirën e të gjithëve. Që nga viti 2010, më se 250 qytete të BE kanë marrë pjesë në 6 edicione të Shpërblimeve për Qytetin me Qasjen më të Mirë, që jepen me rastin e Konferencës në Ditën për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Me rastin e Ditës Evropiane për Personat me Aftësi të Kufizuar, Komisioni Evropian, së fundmi e shpalli Milanon (Itali) fitues të çmimit për Qytetin me Qasjen më të Mirë për vitin 2016. Viesbaden (Gjermani), Tulus (Francë), Vasa (Finlandë) dhe Kaposvar (Hungari) gjithashtu u shpërblyen për përpjekjet e tyre për të përmirësuar qasjen për njerëzit me aftësi të kufizuar si dhe të moshuarit.

67 “Statusi i personave me aftësi të kufizuara, i kushtëzuar nga buxheti,” Koha Ditore, 3 nëntor 2016.

68 Hilmi Jashari, Avokat i Popullit, intervistë me EC Ma Ndryshe, 29 shtator 2016.

Milano përveç përpjekjeve të shkëlqyera dhe të vazhdueshme për qasje, gjithashtu ka kryer projekte për të promovuar punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuar dhe për të mbështetur jetesën e pavarur të tyre. Standardet e tij të ndërtimit jo vetëm që e mbështesin qasjen dhe përdorimin, por ato gjithashtu promovojnë standardet e Universal Design, të cilat mëtojnë të dizajnojnë produkte dhe hapësira në një mënyrë që të mund të përdoren nga një numër i madh njerëzish. Milano është fitues i Çmimit për Qytetin me Qasjen më të Mirë në BE për vitin 2016, jo vetëm për hapat e tij mbresëlënës për të përmirësuar qasjen në të shkuarën, por edhe për planet e tij ambicioze për të ardhmen.

Viesbaden, kryeqyteti i shtetit federal gjerman Hesën e merr vendin e dytë në njohjen e përpjekjeve të tij për të krijuar një qytet të qasshëm për të gjithë qytetarët për shembull duke vënë qëllime ambicioze për të siguruar qasjen në qendrën e qytetit dhe hapësirat e veta të hapura, parqet dhe sheshe lojërash.

Tulus, qyteti i katërtë më i madh në Francë e fiton vendin e tretë. Qyteti është i përkushtuar në përmirësimin e jetës për qytetarët e vetë me aftësi të kufizuara, qoftë në fushën e transportit ku metrotë, trenat dhe autobusët janë 100 për qind të qasshëm apo në sektorin e kulturës ku operat shfaqen me audio-përshkrim dhe programet janë të disponueshme në shkronja të mëdha apo në shkrimin Brail.

Tulus po ashtu ka fituar çmimin special përurues të "Smart City": Ka krijuar ueb faqe të qasshme me informata lidhur me qasjen, të cilat përmbajnë informata lidhur me atë se cilat kalime për këmbësorë kanë udhëzues me audio për ata që kanë pengesa në të parë si dhe për vendndodhjen e hapësirave për parkim për personat me aftësi të kufizuar.

Qyteti finlandez **Vasa** shpërblehet me çmimin special për përkushtimin e tij në përmirësimin e ambientit të punës për banorët e vetë të vjetër dhe me aftësi të kufizuar.

I ndodhur në jug-perëndim të Hungarisë, **Kaposvar** gjithashtu u shpërblye me çmimin special, me që ndërtesat publike të qytetit të renovuara së fundi

mburren me planet e prekshme dhe rrugët e prekshme plus mbishkrimet me Brail për të asistuar të verbrit dhe ata me aftësi të kufizuar në të parë.⁶⁹

VII. Rekomandime

Për Kuvendin e Kosovës: Deputetët dhe organet e Kuvendit të Kosovës duhet të ndërmarrin hapa të nevojshëm për mbikëqyrjen parlamentare të zbatimit të legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me të drejtat e PAK dhe të kërkojnë llogari nga organet Ekzekutiv të nivel qendror dhe lokal për lëshimet apo dështimet eventuale në zbatim. Të punohet në avancimin e mëtutjeshëm të legjislacionit për PAK dhe gjatë miratimit të buxhetit të planifikohen e ndahen mjetet e nevojshme financiare për zbatimin e tij.

Për Qeverinë e Kosovës: Ekzekutivi i Kosovës të zbatojë politika që mundësojnë përmbushjen e pesë objektivave kryesore të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, të përshpejtojë zbatimin e Planit të Veprimit, dhe të hyjë në dialog me qeveritë lokale për zbatimin e politikave që mundësojnë realizimin e të drejtave të PAK, duke krijuar një mjedis më të mirë për jetë, punë dhe kreativitet, me qasje të plotë fizike. MMPH të rris kapacitetin monitorues për zbatimin e legjislacionit të sponsorizuar nga ky dikaster. MPMS të promovojë punësimin e PAK. MASHT të sigurojë cilësi dhe staf ndihmës për arsimin e PAK. MSH të mundësojë shërbime të duhura shëndetësore për PAK.

Për Komunën e Prizrenit (dhe komunat tjera): Zbatimi i hapave të përgjithshëm për të siguruar një qytet pa barriera⁷⁰:

69 "Disabilities: Access City Award 2016 for accessible-friendly cities goes to Milan!," 8 dhjetor 2015, linku: <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=89&newsId=2410>, qasur më 11 gusht 2016.

70 "Si të projektohet për një qytet pa barriera," publikim i EC Ma Ndryshe, nëntor 2016, http://ecmandryshe.org/repository/docs/161123204838_Ecmandryshe_manuali_nov2016_alb_final.pdf, qasur më 29 nëntor 2016.

1. Evidentimi i gjendjes aktuale në mjedisin e ndërtuar
 - Auditimi i barrierave dhe pengesave në ndërtesa publike dhe hapësirë publike të qytetit për të ditur shkallën e problemit dhe për të planifikuar intervenimet për përmirësim.
 - Evidentimi i barrierave arkitektonike në hapësirë publike të vendosen në hartë, për të pasur informata në lidhje me shtrirjen hapësinore të problematikës së qasjes, por edhe për të ofruar komunitetit PAK një informatë shtesë për hapësirat në të cilat aktualisht mund të kenë probleme për qasje.
2. Pjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje për mjedisin e ndërtuar është aspekti crucial për sigurimin e një qyteti pa barriera. Komuniteti, e në veçanti ai i PAK, duhet të jetë pjesë e të gjitha fazave të hartimit të politikave për mjedis pa barriera, por edhe e planifikimit të mjedisit të ndërtuar. Planifikimi me pjesëmarrje siguron që asnjë nga grupet e komuniteteve të mos jenë të përjashtuara nga zhvillimet në shoqëri, meqë hapësira e ndërtuar falë procesit të tillë, promovon lëvizje të lirë, zhvillim, punësim, arsim dhe në përgjithësi barazi sociale.
3. Themelimi i një bordi këshilldhënës për qytet pa barriera në kuadër të departamentit komunal për urbanizëm dhe planifikim. Ky bord i cili do të përbëhet nga përfaqësues të komunitetit (persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, të rinj, gra, komunitetet pakicë, zyrtarë të urbanizmit dhe planifikimit nga komuna, arkitektë, planerë dhe inxhinierë ndërtimi, shoqëri civile, etj.) do të këshillojë rreth zbatimit të kuadrit ligjor dhe politikave për qasje për PAK dhe komunitetet tjera në projektet ndërtimore në qytet; do të involvohet në projektet publike për të bërë auditimin e projekteve në fazën e aplikimit për leje, si dhe do të monitorojë procesin e dhënies së kontratave për punë ndërtimore për ndërtesa dhe hapësira publike, apo cilido intervenim mjedisor që ka impakt në jetën publike të qytetarëve.
4. Të vendoset një sistem interaktiv dhe i qasshëm informativ, përmes aplikacioneve për telefona, kompjuterë, apo sistem sms

falas, përmes të cilave qytetarët do të raportojnë problemet e qasjes fizike në qytet, shkeljet në ndërtesa dhe hapësirë publike (rampa që ndërtohen jashtë standardeve, bllokim trotuaresh me makina, reklama, sipërfaqe rrugore të dëmtuara, parkingje të PAK të zaptuara nga makina të tjera, etj.)

5. Të bëhet një kampanjë vetëdijesuese për të gjithë qytetarët, në lidhje me rëndësinë e qasjes fizike dhe lëvizjes së lirë për PAK dhe komunitete të tjera në qytet.
6. Të trajnohen zyrtarët e drejtorive relevante në komunë dhe institucione të tjera publike, si dhe arkitektë e planerët aktivë në qytetin e Prizrenit për projektimin pa barriera, zbatimin e rregulloreve dhe kuadrit ligjor për mjedis të ndërtuar të qasshëm.

Për Avokatin e Popullit: Të intensifikojë angazhimet për evidentimin e pengesave që komuniteti PAK ka në raport me qasjen në ndërtesat e institucioneve publike, shërbimet shëndetësore, arsimore, punësim, etj.

Organet e Drejtësisë: Të zhvillojnë fushata informuese për publikun në lidhje me procedurën për iniciimin e lëndëve sa i përket diskriminimit mbi bazat e aftësisë së kufizuar, rrjedhimisht edhe të pengimit të qasjes për PAK, dhe më pastaj të zbatojnë dispozitat sanksionuese ndaj të gjithë atyre që i neglizhojnë obligimet ligjore në këtë drejtim.

Institucionet akademike – Universitetet: Të fusin module të obligueshme për projektim pa barriera në kurset e studimeve të arkitekturës.

